



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Metodologji e Punës Kërkimore Universitare

Ngarkesa:: 4 kreditë; 40 seanca seminar
Viti / Semestri : Viti I, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje
Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Dukë parë vështirësitë që studentët hasin gjatë organizimit të punës së tyre studimore dhe kërkimore gjatë cikleve të studimeve universitare, kjo lëndë i ndihmon ata në procesin e kryerjes së kërkimeve shkencore, të përzgjedhjes dhe të organizimit të materialit shkencor të gjetur, lidhur me një çështje të caktuar, sipas fushave të studimit dhe në njohjen e teknikave për të përgatitur studim të mirëfilltë duke u dhënë konceptet për pasqyrimin e një bibliografie; për përdorimin e bibliotekës dhe burimeve të reja të informacionit; përmjetet dhe mënyrën e mbajtjes së shënimeve, si të përmbledhin një artikull apo një libër; të angazhohen për të punuar në grupe; për të organizuar një hulumtim dhe të strukturojnë një projekt profesional; të ndërtojnë dhe paraqesin një studim të tyre para një auditori, si dhe të respektojnë të drejtën e autorit.

Objektivat specifike lëndore:

1. Studenti njihet me objektivat e këtij kursi, I cili ofron teknika dhe metoda të nevojshme për kryerjen dhe paraqitjen e detyrave të ndryshme universitare.
2. Studenti njihet me nocionin e të nxënit, me mjetet ndihmëse si teknika dhe strategjitë e të mësuarit si edhe me faktorët që e pengojnë atë sikurse janë faktorët socio-afektivë, pragmatikë dhe teknikë. Ata njihen konkretisht me organizimin dhe funksionimin e një biblioteke.
3. Studenti të paraqiten teknika e të mbajturit shënim si ndërtimi i fishave, skemave, shkurtimet, simboletetj. Gjithashtu, student njihet me kriteret e prezantimit me gojë të një projekti ose studimi. Studenti duhet të jetë aktiv çdo séance dhe të realizojë objektivat e përcaktuara nga profesori.